

LIGJ
Nr.7546, datë 6.1.1992

PËR ADMINISTRIMIN E TATIMEVE DHE TË TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë administrimi i tatimeve dhe i taksave bëhet nga organet tatimore. Organe tatimore janë drejtoria e tatimeve në Ministrinë e Financave dhe organet e saj në rrethe.

Neni 2

Organet tatimore kryejnë të gjitha veprimet që lidhen me regjistrimin e subjekteve, mbajnë dokumentacionin përkatës, nxjerrin aktet tatimore dhe ruajnë e administrojnë dokumentacionin sipas dispozitave të veçanta.

Neni 3

Akti tatimor nxirret në bazë të deklaratës dhe të dhënave të tjera të paraqitura nga subjektet sipas afateve dhe e kërkesave të caktuara me dispozita ligjore. Organet tatimore përcaktojnë bazën dhe madhësinë e tatimit në aktet tatimore.

Neni 4

Personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, i nënshtrohen tatimit dhe taksave në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimet dhe taksat.

Neni 5

Viti tatimor përputhet me vitin kalendarik.

Neni 6

Tatimet paguhen në lekë shqiptare, përveç rasteve kur me dispozita të veçanta parashikohet ndryshe.

Për efekt të llogaritjes së tatimit, të ardhurat në valutë të huaj konvertohen në lekë shqiptare, sipas kursit të shpallur nga Banka e Shtetit në ditën e llogaritjes së tyre.

Neni 7

Në rastet kur personat fizikë a juridikë janë rezidentë të shteteve, me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar konventa, për mënjanimin e tatimeve të dyfishta, ndaj tyre zbatohen dispozitat e parashikuara në këto konventa.

Neni 8

Organet tatimore kanë të drejtë:

- a) Të kontrollojnë dokumentet që vërtetojnë saktësinë e tatimit, derdhjet e shumave përkatëse, saktësinë e deklaratave e të dhënave të tjera, që lidhen me nxjerrjen e tatimeve.
 - b) Të kontrollojnë në vend gjendjen e lëndëve të para e ndihmëse, të prodhimeve të gatshme a të materialeve të tjera që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë.
 - c) Të kërkojnë të dhëna, njoftime e sqarime nga çdo subjekt dhe, kur e shohin të nevojshme, të marrin ekspertë.
- Organet tatimore, për të ushtruar kontroll, paraqesin dokument identiteti.

Neni 9

Kur të ardhurat vjetore ose fitimi vjetor nuk mund të përcaktohet për shkaqe të parregullshmërisë në dokumente ose për shkaqe të papërligjura, organi tatimor ka të drejtë të përcaktojë vetë tatimin, duke marrë për bazë:

- dokumente me të dhëna vërtetuese;
- llojin dhe karakterin e veprimtarisë, xhiron, numrin e punonjësve, rrethin e klientelës;
- fitimin e realizuar, të ardhurat e subjekteve të tjera që ushtrojnë veprimtari të ngjashme me të.

Neni 10

Organet tatimore janë të detyruara të ruajnë fshehtësinë e të dhënave dhe dokumenteve tatimore. Këto mund t'u jepen vetëm organeve të drejtësisë ose organeve a personave që përcaktohen në marrëveshjet me shtetet e tjera.

Neni 11

Agjentët e tatimeve detyrohen të kryejnë të gjitha veprimet që lidhen me mbledhjen, mbajtjen dhe derdhjen e tatimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimet.

Neni 12

Çdo subjekt që ushtron veprimtari private dhe ka fituar zotësi për të vepruar, regjistrohet në organet tatimore brenda 15 ditëve nga dita e fillimit të zotësisë për të vepruar.

Neni 13

Për regjistrimin në organet tatimore subjektet paraqesin kërkesën me shkrim, ku përfshihen emri dhe mbiemri, emërtimi i subjektit, adresa e plotë, lloji i veprimtarisë, forma e organizimit të veprimtarisë, marrëdhëniet e vartësisë dhe të dhëna të tjera të veçanta.

Neni 14

Organet tatimore kur gjatë shqyrtimit vërejnë se kërkesa dhe dokumentet janë të rregullta, brenda 10 ditëve bëjnë regjistrimin dhe pajisin subjektin me certifikatën përkatëse.

Neni 15

Personat juridikë a fizikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike, detyrohen të mbajnë dokumente në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin".

Neni 16

Kur tatimi i llogaritur me atë të derdhura kanë diferenca, bëhet rillogaritja e tij dhe veprimet kryhen brenda 30 ditëve nga data e konstatimit.

Neni 17

Akti që përcakton tatimin e taksën, është titull ekzekutiv. Ankesa nuk e ndërpret detyrimin për derdhjen e tyre.

Neni 18

Kur me një veprim kryhen disa shkelje tatimore ose i njëjti person kryen disa shkelje të veçanta, merren masa veças për çdo shkelje.

Neni 19

Punonjësit e organeve tatimore, për veprimet që kryejnë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për tatimet dhe taksat, kur ato përbëjnë vepra penale, mbajnë përgjegjësi disiplinore, sipas dispozitave të kodit të punës.

Neni 20

Për mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet subjekteve tatim- pagueuse dhe organeve tatimore për masën dhe mënyrën e llogaritjes së tatimeve, tatimpaguesit kanë të drejtën e ankimit me shkrim, brenda 10 ditëve nga data e lindjes së mosmarrëveshjes, te kryetari i komiteti ekzekutiv të rrethit, i cili detyrohet të kthejë përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve.

Kur subjekti nuk është dakort me përgjigjen e dhënë, ka të drejtë që brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit të ankohet te drejtori i drejtorisë së tatimeve në Ministrinë e Financave, akti i të cilit është i formës së prerë.

Neni 21

Dënimet e parashikuara në legjislacionin për tatimet dhe taksat jepen brenda një viti nga data e konstatimit të shkeljeve, por jo më vonë, se pesë vjet nga kryerja e tyre.

Neni 22

Ministria e Financave të miratojë dokumentacionin e nevojshëm e të japë udhëzime në zbatim të ligjeve për tatimet dhe taksat.

Neni 23

Dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1992.

Shpallur me dekretin nr.109, datë 11.1.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.